

REPUBLIKA E KOSOVES-VLADA / REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY SEKTOR ARKIVES-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit Nr./faqeve Br./stranica No. pages	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No. Data Datum Date
5 2	1083 31.08.2021



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 31.08.2021
 Nr. 5 - 1083

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, 8 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, në bazë të kërkesës për rilicencim nga BPrAL- Kolegji "Iliria" nr. 1083 të datës: 01.07.2021, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa e kolegjit "Iliria"- Prishtinë. nr. 1083 të datës: 01.07.2021, për rilicencim.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave të cekura më lartë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, shqyrtoi kërkesën me nr. prot. 1083 të dt. 01.07.2021, të parashtruar nga kolegji "Iliria" për rilicencim.

Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga kolegji "Iliria", vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet për rilicencim sepse nuk ka ofruar akreditim nga AKA-ja, për programet e cekura në kërkesën e tij, drejtuar Komisionit për licencim të BPrAL-ve.

Parashtruesi i kërkesës së tij ka theksuar se është në proces të akreditimit të jashtëm të AQAS, mirëpo komisioni shqyrton dhe merr parasysh vetëm dëshmitë dhe dokumentacionin që i ofrohet komisionit.

Komisioni, nuk ka pasur asnjë vendim- dëshmi nga parashtruesi i kërkesës se është i akredituar, ndërsa sipas nenit 6 paragrafi 1 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, MASHTI licencon BPrAL të cilat ofrojnë programet e akredituara nga agjencitë e njohura akredituese, anëtare të organizmave ndërkombëtar të akreditimit, pasi programi i tyre të aprovohet nga AKA, që nënkupton se, nëse BPrAL akreditohet nga Agjencitë e jashtme, programi i tyre duhet të aprovohet nga Agjencioni Kosovar i Akreditimit.

Komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Arkivit të MASHTI;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Komisionit për licencim;
4. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
5. DALSHT;
6. DNJBIA;
7. Inspektoratit, MASHTI.

Kryetar i Komisionit

